



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 53, datë 03/11/2004

**“PËR
PAJISJE ME AUTORIZIM DEFINITIV DHE PRIVATIZIM NË GODINAT E
KALUARA NË FOND BANESE NË NJËSINË BASHKIAKE NR.6”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Për pajisje me autorizim definitiv dhe privatizim në godinat e kaluara në fond banese në Njësinë Bashkiake Nr.6”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “e”, në ligjin Nr.7652, dt.23/12/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.49, dt.29/01/1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.250, dt.16/04/1996 “Për procedurat dhe prioritetet”, në Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1440, dt.04/04/1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”, në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.97, dt.17/06/1997 “Për kalimin në fond banese të ish-shkollës së mesme bujqësore, të hotelit të punëtorëve të ish-NNI-së së Elbasanit dhe të ish-shkollës së ulët të ndërtimit në Qytetin e Nxënësve”, në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.160, dt.10/10/1996 “Për kalimin në fond banese të ish-konviktit të shkollës së ulët të kursit 1-vjeçar të industrisë, Rruga “Haki Stërmilli”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.60, dt.30/04/1996 “Për kalimin në fond banese të godinës së Qendrës së Kualifikimit të Punonjësve të Kulturës”,

V E N D O S I;

I. Të pajisen me autorizim definitiv qytetarët, sipas strukturave përkatëse:

1. Eqerem Sabri Xhaferaj - 1+1, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
2. Iljas Baki Kryemadhi - 1+1, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
3. Marjana Hasan Dajlanaj - 1+1, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
4. Lulzim Xhevdet Faiku - 1+1, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
5. Kadri Qemal Ruli - 1 dhomë, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
6. Mikel Llesh Macaj - 2+1, sipas planimetrisë bashkëlidhur.

II. Të bëhet privatizimi sipas strukturave përkatëse, sipas pikës 1 të këtij Vendimi.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI